

**UDHËZIM**  
**Nr. 8, datë 23.5.2018**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.2.2018,  
“PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË  
FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar; të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 12.10.2016, “Për miratimin e strategjisë kombëtare të peshkimit, për periudhën 2016–2021”; të ligjit nr. 109, datë 30.12.2017, “Për buxhetin e vitit 2018”; të pikës 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 72, datë 7.2.2018, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 21, datë 12.1.2018, “Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29.10.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor, 2014–2020”; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 22, datë 12.1.2018, “Për miratimin e kriterëve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit”, të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”,

**UDHËZOJMË:**

Në udhëzimin nr. 1, datë 19.2.2018, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

Në kreun VII:

1. Pas pikës 8, shtohet pika 8/1: “Në rast se aplikuesit e shpallur në listën paraprake të fitueseve nuk kanë dorëzuar pjesërisht ose plotësisht dokumentacionin brenda afatit të mësipërm, AZHBR-ja njofton publikisht në faqen e vet zyrtare: [www.azhbr.gov.al](http://www.azhbr.gov.al), pranë zyrave të aplikimeve për dorëzimin e dokumentacionit plotësues, brenda 15 ditëve pune nga data e publikimit të këtij njoftimi.”.

2. Pas pikës 12 shtohet pika 12/1 me këtë përmbajtje:

“12/1. Verifikimi në terren bëhet pavarësisht gjenerimit nga regjistrat zyrtarë të vërtetimit për shlyerjen koherente të sigurimeve shoqërore.

Grupi i verifikimit në terren administron edhe vërtetimin e bankës për numrin e llogarisë bankare të aplikuesit, nëse ky vërtetim nuk është dorëzuar më parë.”.

3. Në pikën 13, togfjalëshi “prill–maj” zëvendësohet me togfjalëshin “prill–qershor”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË  
DHE ZHVILLIMIT RURAL  
**Niko Peleshi**

MINISTRI I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Arben Ahmetaj**